

RELACION TEKNIKE

**EMERTIMI OBJEKTIT RIKONSTRUKSION I
ÇERDHES NR-2 PA NDRYSHIM TË STRUKTURES
EGZISTUESE
NE BASHKINE ELBASAN**

Te pergjithshme

Bazat ligjore ne te cilat jane mbeshtetur projekti dhe relacioni shpjegues jane:

- Ligji Nr.152, date 21.12.2015 "Per Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin"
- Neni39 : Projekti per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin
- Neni 40 : Detyrimet e hartuesit te projektit per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin
- Vendimi i Keshillit Ministrave Nr.162 date 19.04.1965
- Per miratimin e "Rregullorja mbi masat mbrojtese kundra zjarrit ne projektimin e ndertesave te 9do lloji"
- Vendimi i Keshillit Ministrave Nr. 626, date 15.07.2015
Per Miratimin e Normativavete
Projektimit te Banesave
- Urdheri i Ministrit Puneve te Brendshme
Nr. 424 date 24.07.2015
- Per "Miratimin e Rregullave Teknike per Mbrojtjen nga Zjarri dhe per Shpetimin ne Ndertimet e Destinuara per Banim"
- Urdheri i Ministrit Pushtetit Vendor e
Decentralizimit Nr. 45 date 09.04.2004
- Per miratimin e rregullores "Per masat e mbroitjes nga zjarri ne depo dhe magazina te ndryshme"
- Udhezimi i Ministrit Puneve te
Brendshme nr. 425 date 24.07.2015
- Per "Pranimin, Administrimin e Dokumentacionit Teknik dhe Grafik te Projektit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe per Shpetimin dhe Leshimin e Akteve Teknike"
- o Shenjat Konvencionale dhe Treguese te Dokumentacionit
Teknik dhe Grafik te Projektit te Mbrojtjes nga
Zjarri dhe per Shpetimin
- Urdher nr. 424, datë 24.7.2015
Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për
shpëtimin në ndërtimet e destinuara për banim

Ne ndertesat e banimit ne ndertesat shoqerore administrative si dhe ne repartet e ndermasrrijeve te prodhimit si rregull ujesjellesi kundra zjarrit bashkohet me sistemin e furnizimit me uje per nevojat ekonomiko-pirje apo me ate te nevojave teknologjike. Duke u mbeshtetur ne normat e projektimit ujesjelles kundra zjarrit ndertohet ne keto raste :ne ndertesat e banimit mbi 8 katene ndertesat administrative dhe shoqerore ne ndermarrjet e prodhimit me perjashtim te atyre ndermarrjeve ku mund te ndodhe eksplozim ose shperndarje e zjarrit nga uji. Struktura ndertimore e objektit eshte e perbere me materiale te padjegshme. Djegshmeria e nderteses kufiri minimal i qendrueshmerise ndaj zjarrit dhe shkalla e qendrueshmerise ndaj zjarrit te struktures se objektit eshte

Muret perimetrare dhe muret ndarese jane prej tullash me argjil te pjekur .Keto lloj tullash jane te padjegshme me kufi minimal te qendrueshmerise ndaj zjarrit prej 5.5 ore Kollonat mbajtese jane prej betoni te armuar keto lloj kollonash jane te padjegshme me kufi minimal te qendrueshmerise ndaj zjarrit prej 4.5 ore. Mbeshtetur ne keto objekti klasifikohet ne shkallen "I" te qendrueshmerise ndaj zjarrit. Vendosja e elementeve perberes te objektit siguron mundesi mjaft te medha operimi sherbimit te nderhyrjes se mjeteve zjarrfikese evakuimit te njerezve dhe mjeteve. ambjentet e sherbimit jane te pajisura me hapësira te nevojshme per evakuimi ne rast zjarri. Objekti ka si funksion perdorimi si arsimimi para shkollor dhe ka probabilitet te ulet per ndonje zjarr te mundshem, megjithate duhet te merren masat maksimale , gje qe kerkon nje mbrojtje sa me efikase. Mbrojtja eshte planifikuar te behet me autozjarrfikese, **por megjithate po i ofrojme investitorit per zbatim edhe nje variant me fikese dore me pluhur (shuares te thate) dhe dedektorë tymi.**

Bombol me pluhur (Trivalent, me sulfat amoni dhe fosfat monoammonik, për klasat e zjarrit A, B dhe C). Ne kete objekt banimi per evakuimin nga objekti do te perdoren shkallet dhe dyert e objektit. Nga ky objekt evakuohet nëpërmjet shkallëve të brëndshme dhe derës së jashtme.

KLASIFIKIMI I PERGJITHSHEM I ZJARREVE

Klasa A

Zjarre qe perfshijne materiale qe digjen lirshem si dru leter tekstile dhe te tjere me baze qymyri

Fiksate pershtatshme uje shkume pluhur te tre kategorive A,B,C dhe fikse me mbushje kimike .Fikset jane me etikete te bardhe te verdhe dhe blu

Klasa B

Zjarre qe bien ne lengje te ndezshem nafte lende djegese diesel solvent lubrifikante dhe vajgure. Nuk perfshihen alkooli dhe vaj i gatimit . Fiksate pershtatshme uje shkume pluhur te tre kategorive A.B.C dhe fikse me mbushje kimike

,ga\ karbonik .Fikset jane me etikete te verdhe ose blu

Klasa C

Zjarre qe ndodhen ne gaze te ndezshem butan, propan

Fiksate pershtatshme me pluhur A,B,C dhe fikse me mbushje kimike gaz karbonik .Fikset jane etikete blu

Klasa D

Zjarre që ndodhen në metale të ndezeshëm sodium litiun magnezium dhe aluminkur është pluhur.

Fikse L2 pluhur dhe M28 pluhur .Fikset janë me etikete blu

Klasa E

Zjarre që ndodhen në paisje elektrike

Fikset me pluhur ABC pluhur i thatë dhe gaz karbonik CO₂ .Fikset janë me etikete blu

Klasa F

Zjarre që ndodhen në vaj gatimi ose në yndyrna

Fikset me mbushje kimike.Fikset janë me etikete të verdhe

Shkaqet dhe rreziqet me të shpeshta të ndodhjes së zjarreve

Depozitimi ose perpunimi i parregullt i substancave të perflakshme ose të djegshme

Grumbullimi i mbetjeve të trashura ose i materialeve të tjera të djegshme të cilat mund të ndizen lehtësisht aksidentalisht ose lirshëm

Mos zbatimi i rregullave të sigurisë kur përdorim flake të lira ose aparate që clirojnë nxehësi Mos pastrimi i ambienteve nga materiale që ndizen lehtësisht.

Djegja e kabllave të paisjeve elektrike si rezultat i modifikimeve apo riparimeve nga persona jo të kualifikuar.Djegja e kabllave të paisjeve elektrike si rezultat i qëndrimit të tyre nën tension edhe gjatë kohës që ato janë jashtë përdorimit.Përdorimi jo korrekt i aparateve ngrohës të levizshëm.Dëmtimi i aparateveventilues të aparateve ngrohës makinerive dhe aparateve elektrike

Pirja e duhanit dhe hedhja në vende të ndalluara rreptesisht

Procedurat që ndërmerren në rast zjarri

Procedurat që ndërmerren në rast zjarri janë të ndryshme para se gjithash për zgjedhjet e veprimeve në ambiente të ndryshme .por procedurat e përgjithshme që përdoren në rast të zbulimit të një zjarri janë.

Familjarizohuni sipas procedurave të paracaktuara

- Në rast se behet fjale për një zjarr kryesor vlerësoni situatën vendosni nëse egziston mundësia të shuhet menjëherë me mjete shuarese dore
- Mos tentoni të veproni për shuarjen e tij me mjete të dorës portative nëse nuk keni siguri që se shuaarja mund të behet me to
- Jepni menjëherë alarmin (telefonozjarrfikeset)
- Nderprisni furnizimin me gaz ose energji elektrike nëse ka
- Kufizoni përhapjen e zjarrit dhe tymit mbyllni portat ose ndarjet e dhomave
- Filloni veprimin për shuarjen vetëm kur jeni të garantuar për rruget e largimit si dhe kur jeni të sigurtë për mbrojtjen nga mbrapa dhe keni prezencën e personave të tjerë
- sigurohuni që objekti është evakuar
- Nëse nuk mund të vendosesh nën kontroll zjarrin në kohë të shkurtra dil jashtë ndërtesës dhe jep përkrahimin e duhur tek skuadra e zjarrfikësve

Procedurat që ndërmerren në rast alarmi

Edhe ne kete aspekt procedurat qe ndermerren ne rast alarmi jane te ndryshme per tipe te ndryshem zjarresh. Sidoqofte ne raste alarmika operacione te pergjithshme qe ndiqen Ruani qetesine (njohja e mire e procedurave ndihmonshume ne kryerjen e sakte te veprimeve)

- Respektoni ne menyre strikte veprimet e pershkruara ne planin e emergjencave
- Perjashtoni mundesine e transmetimit te planit nje personi te trete
- Jepini asistence kujdo qe ndodhet ne pozicion te veshtire nese keni mundesi largohuni menjehere sipas procedurave
- Mos hyni ne ndertese nese nuk jane vendosur kushtet normale

Menyrat e largimit

Objektivi kryesor ne nje plan emergjence eshte ai i shpetimit te njerezve qe ndodhen ne mjedise te rrezikshme. Ne planin e largimit mbahen ne konsiderate perdorimi i rrugeve te largimit vend grumbullimet shpejtesia e levizjes shenjat fluoreshente te drejtimit te levizjes etj. Procedurat e lajmerimit te ndihmes se shpejte

Nje administrim i mire i emergjences fillon me shpejtesine dhe saktesine e lajmerimit te skuadrave te ndihmes se shpejte . Nje kerkese per ndihme duhet te permbaje keto te dhena

o Adresen e sakte te objektit

- Tipi i ndihmes se emergjence qe kerkohet
- Persona te demtuar apo te plagosur
- Lloji i objektit te demtuar
- Stadi i zhvillimit
- Vecori te tjera
- Te dhena per rrugen

PUNOI

Ing. Erion STAMBOLLXHIU
Leje Nr-6609 Date-25/08/2015

Ing. Bruno KORUMI